

STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"TULIP TOUCH" shpk

Ky statut perpilohet sot me dt 17.02.2025 nga :

- Znj. Fiona Metohu e ditelindjes 28.04.1999., lindur ne Almere,Hollande, banuese ne Tirane, pajisur me pasaporte nr BA5705828....

Bazuar ne Legjislacionin ne fuqi, veçanerisht ne ligjin ,nr 9901 dt 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare "dhe sipas marreveshjes se ortakut te vetem dhe aktit te themelimit te hartuar prej tij hartohet ky statut dhe ne zbatim te Ligjit 9723 date 03.05.2007" Per Qendren Kombetare te Regjistrimit ".

Neni 1

Shoqëria themelohet si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (Sh.p.k.), e regjistruar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Emri i plotë i shoqërisë është "Tulip Touch" Sh.p.k.

Neni 2


Selia qendrore e Shoqërisë ndodhet në 'Tirana Business Park, Nd.07, Rruga e Rinas'. Shoqëria mund të hapë filiale ose zyra të tjera brenda dhe jashtë vendit, sipas nevojave të veprimtarisë së saj dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 3

Shoqëria është e themeluar dhe zotëruar nga një ortak i vetëm, Fiona Metohu, J95428040B, e cila është gjithashtu administratore dhe përfaqësuese ligjore e saj.

Neni 4

Shoqeria do te zhvilloj aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pacaktuar.



Neni 5

Administratori i shoqërisë është Fiona Metohu për një periudhë 5 vjeçare sipas ligjit.

Neni 6

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- Organizimin dhe menaxhimin e eventeve të ndryshme, duke përfshirë konferenca, seminare, workshope, panaire, inaugurime dhe evente festive.
- Ofrimin e shërbimeve të përkthimit me shkrim dhe interpretimit simultan dhe konsektiv.
- Marrjen dhe dhënien me qira të pajisjeve audio-vizuale, sistemeve të përkthimit, sistemeve audio dhe LED wall për evente të ndryshme.
- Bashkëpunimin me hotele dhe struktura të ngjashme për organizimin e eventeve dhe ofrimin e shërbimeve të akomodimit.
- Ofrimin e shërbimeve fotografike, printimeve, kancelarisë, si dhe angazhimin e hosteve për evente të ndryshme.
- Realizimin e video - animacioneve, dizajnit grafik, prodhimin dhe montimin e reklamave indoor dhe outdoor.
- Kryerjen e veprimtarive të import-eksportit të pajisjeve teknike, mallrave dhe automjeteve.
- Ofrimin e shërbimeve të cateringut dhe bar-restoranteve.
- Shitjen me pakicë të artikujve promocionalë, stampimin dhe magazinimin e tyre.
- Organizimin e fushatave promocionale në terren dhe online.

Neni 7

Kapitali fillestar i Shoqërisë është 100.000,00 LFK (njëqindmijë), i cili është zotëruar 100% nga ortaku i vetëm, Fiona Metohu. Çdo ndryshim në kapitalin e Shoqërisë do të vendoset nga ortaku i vetëm dhe do të pasqyrohet në regjistrin tregtar.

Neni 8

Kontributi i përcaktuar në nenin 6 të këtij statuti i takon Ortakeve të shoqërisë.



Neni 9

Fitimi i realizuar nga aktiviteti i shoqërisë i mbetet në përdorim ortakut të vetëm. Shoqëria është përgjegjëse për detyrimet e saj vetëm deri në vlerën e kapitalit të saj të deklaruar. Ortaku i vetëm nuk mban përgjegjësi personale për borxhet dhe detyrimet e Shoqërisë përtej kontributit të tij në kapital.

Neni 10

TRANSFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT THEMELTAR

Kuotat e kapitalit të shoqërisë mund të transferohen me anë aktesh mes të gjalleve dhe me trashëgimi.

Neni 11

Çdo çështje që nuk është e parashikuar në këtë statut do të rregullohet sipas dispozitave të Kodit të Shoqërive Tregtare të Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 12

AKTIVITETI FINANCIAR

Në çdo mbyllje çdo viti financiar administratori bën inventarin dhe llogarite vjetore në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për kontabilitetin, si dhe hartohet një raport me shkrim. Bilanci i bashkëngjiten:

Një situacion mbi garancitë e dhëna nga shoqëria.


Një situacion mbi sigurimet e bera nga shoqëria.

Raporti i administratoreve përfshin gjendjen gjatë vitit financiar të kaluar, ndryshimet e parashikuara, veprimtaritë e mundshme që janë zhvilluar nga data e mbylljes së vitit financiar deri në ditën që është hartuar ky raport.

Neni 13

Shoqëria ka të drejtë të punësojë punonjës që i nevojiten për të ushtruar veprimtarinë e saj.

Punësimi bëhet sipas kushteve të përcaktuara në legjislacionin e punës së Republikës së Shqipërisë, si dhe rregullave të vëna në kontratën e vecantë të punësimit që lidhet midis punëdhënësit dhe punonjësit. Të gjitha problemet që do të lindin gjatë ushtrimit të



veprimtarise private te kesaj shoqerie do te zgjidhen sipas rregullave te percaktuar ne statutin dhe legjislacioni ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

Neni 14

Hartuar dhe miratuar më 17.02.2025 nga ortaku dhe administratori i vetëm i "Tulip Touch" Sh.p.k., Fiona Metohu.

ORTAKU I VETEM THEMELUES
Fiona Metohu

Fiona Metohu

